



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11, 17 shkronja r, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 7 parag. 1.1 të Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë nr.03/L-145, nenit 16 parag. 3 të Udhëzimit Administrativ për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor Lokal nr.9/2010, neneve 14, dhe 17 shkronja r, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, nenit 9 parag. 2 të Rregullores nr.01-006-93314 për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, dhe nenit 3 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 të datës 28 maj 2012, në kërkesë të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Podujevë nr.09-400/04-22304/17 të datës 21.03.2017, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2017, miratoi

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE KËSHILLIN E VEPRIMIT RINOR LOKAL NË PODUJEVË

Neni 1

Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – KVRL në Podujevë, për realizimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative në kuadër të veprimtarisë sipas Planit të veprimit rinor Lokal 2017 - 2019, mbështetet me mjete financiare në shumë të gjithmbarshme prej 4,190.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër planifikimeve buxhetore të miratuara për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Shuma e mjeteve bartet në llogarinë bankare të KVRL- së përkatëse.

Neni 3

Vendimin e zbaton Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-060/04-26122/17
Podujevë,
31 mars 2017

